



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:172039

Datë: 27.10.2023

Numri i dokumentit: 04842620

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.709/22

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari e vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtësen Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të pandehurit Z. K. nga Peja i akuzuar për veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 te Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1615/2022 të datës 16.08.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 02.10.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit Z. K. me mbrojtësin Av.Gani Kelmendi dhe të dëmtuarit Sh. N. me datë 02.10.2023 shpalli ndërsa me datë 27.10.2023 përpiloj këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri:

Z. K. , i biri I.dhe nënës Sh. e gjinisë B., i lindur me dt. ne fsh. T.K-M., me vendbanim ne rr. “B.B.” nr- K-Peje, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i martuar baba i gjashtë fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike , me lnj.nr....., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Më datën 03.08.2022, rreth orës 14:00 në rr.” B. B.-A.” K. Pejë, ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon, në vend se t’i drejtohet organit kompetent, në atë mënyrë, i pandehuri pa paralajmërim paraprak dhe për shkak të raporteve jo të mira që ka me vëllain e tij vendos një dry në lokalin e vëllait të tij të cilën e shfrytëzonte me qira i dëmtuari Sh. N., ku i dëmtuari sa po shkon për të hapur lokalin vëren se të njëjtit lokal i është vendosur edhe një dry

tjetër ku vendosjen e këtij dryni e pranon se ka vendosur i pandehuri, pa ju drejtuar organit kompetentë.

- Me çka ka kryer veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.
-

Prandaj, gjykata në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42,45, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit Z. K. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga pala e dëmtuar.

ARSYETIM

A) Historiku i çështjes, qëndrimet e palëve dhe fajësia ;

Prokuroria Themelore në Pejë pranë kësaj gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1615/2022 të datës 16.08.2022 kundër të pandehurit Z. K. për shkak të veprave penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Gjykata me datë 02.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri Z. K. me mbrojtësin av.Gani Kelmendi dhe i dëmtuari Sh. N..

Pasi qe gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet e ftoi të njëjtin qe të deklarohet në lidhje me akuzën, ku i pandehuri Z. K. e pranoi fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë si në aktakuzën objekt shqyrtimi në këtë çështje penale.

Pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të të pandehurit dhe të dëmtuarit në lidhje me pranimin e fajësisë të cilët i propozuan gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 242 par 2 dhe 6 të KPPRK-së vlerësoj se plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi qe është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza dhe provat e pranueshme qe e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë si te tillë.

B) Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 42, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

1. Përcaktimi i dënimit ;

Kur vendosi në lidhje me dënimin me burgim gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 410 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) qe e përcakton veprën penale Vetëgjyqësisë dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Neni 410 par.1 i KPPRK-së, përveç qe përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit, qe është dënim me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin Z. K. .

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh për të pandehurin u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, qe sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale nga neni 410 par.1 të KPRK-së është dënimi prej tre muaj burgim¹. Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

2. Vlerësimi i provave dhe argumenteve të palëve për rrethanat renduese dhe lehtësuese; Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë qe të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës nga provat e bashkëngjitura dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata arriti qe të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Palët të gjithë sipas radhës i dhanë vlerësimet dhe propozimet e tyre në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Prokurori i shtetit në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi “Meqenëse i akuzuar e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe një gjë të tillë e bere konform kushteve ligjore të parapara me neni 242 të KPPRK-se dhe në përputhje të plote me të gjitha provat materiale dhe personale në të cilat mbështetë kjo aktakuze, nga gjykata kërkoj qe të njëjtin ta shpalle fajtor ta dënoj sipas ligjit dhe të obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa në rastin e përcaktimit në llojin dhe lartësinë e dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethane lehtësuese”.

I dëmtuara Sh. N. deklaroi “ Unë kam me thonë edhe më të rondë, e ka një familje shumë të nderume, sa i përket rastit kemi pas telashe edhe pas këtij rasti, ku me ka thonë “ose unë në burg e ti në dhe, ose unë në dhe e ti në burg”, por falë Zotit kam respekt për vëlla të tij shumë dhe më ka thonë “Sh. duroje”, dhe ju kam larguar sepse ky më vike të hundët në dugojë. Sa i përket

¹ Udhëzues për Politiken Ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 201.

dënimit ja lë në vlerësim të gjykatës por ju tregoj se ky është i padisiplinuar dhe përdorë fjalë fyese gjatë gjithë kohës”.

Mbrojtësi i të pandehurit, Av.Gani Kelmendi deklaroi “Kërkoj që të njëjtit ti shqiptohet një vërejtje gjyqësore që mos të veproj si me dt.03.08.2022, për një gjë të tillë është penduar dhe nuk do të përsërisë në të ardhmen”.

I pandehuri Z. K. para gjykatës deklaroi “I dëmtuari po paraqitet ma zotni se unë në shpinë teme, dije mirë se në ç’at vend ki me ndejt ose ti ose unë, dije mirë”.

Tutje i dëmtuari, në seancë vazhdoi të bërtas dhe ti drejtohet në mënyrë kërcënuese të dëmtuarit vazhdimisht, me sjellje shumë agresive, pa përfillur fare urdhrat e gjykatës e as kërkesën e gjykatës për ta ruajtur qetësinë. I njëjti shpreh një mllef të madh në raport me të dëmtuarin me sharje, fyerje dhe kërcënime ne prezence te gjykatës dhe te pranishmeve te tjerë.

Duke u gjendur ne këtë situatë gjykata vendosi qe te pandehurit ti shqiptoj ne procesverbal, vërejtje për ruajtjen e rendit ne gjykatore.

Konstatimi i rrethanave renduese dhe lehtësuese nga gjykata;

Pas analizimit të provave të bashkëngjitura lëndës dhe deklarimeve të palëve, gjykata si rrethanë renduese për të pandehurin Z. K. gjeti shkallën e lartë të dashjes se te pandehurit ndërsa si rrethane lehtësuese e gjeti pranimin e fajësisë.

3. Caktimi i peshës së rrethanave dhe vlerësimi i ndikimit te tyre;

Për të përcaktuar lartësinë e dënimit në rastin konkret gjykata vlerësoj peshën dhe ndikimin e secilës nga rrethanat e përmendura si me lartë.

a) Vlerësimi i rrethanave renduese;

Shkalla e lartë e dashjes nga ana e të dënuarit, shprehet në faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje direkte dhe atë duke i vendosur drynin, duke e mbyllur, duke e bere te paqasëshëm lokalin te cilin e ka në shfrytëzim këtu i dëmtuari.

Nga faktet e parashtruara ne aktakuzë e të cilat i ka pranuar i pandehuri, vërehet se i njëjti ka qene shume i bindur për ndërmarrjen e veprimeve te kryerjes se veprës penale, pasi qe për të vendosur dryrin në një lokal qe ka pasur në shfrytëzim këtu i dëmtuari, i është dashur qe të

ndërmarr veprime të caktuara objektive, te cilat kanë pasur nevojë për ide, aktivitet dhe mund, veprime te cilat nuk mund të ndërmerren nëse të një person nuk është e formësuar një shkallë e lartë e dashjes.

Për të argumentuar edhe me shumë faktin se kjo vepër është kryer në një shkallë të lartë të dashjes, i pandehuri edhe ne seancë, para gjyqtarit të çështjes dhe palëve i drejtohet të dëmtuarit më fjalë kërcënuese, duke insistuar prap se “dije mirë se në ç’at vend ki me ndejt ose ti ose unë, dije mirë”, qe tregon se i pandehuri akoma mbetet pranë pretendimit të shprehur përmes veprimit të kryerjes së veprës penale, pra i njëjti tregon se edhe me tutje është i gatshëm të ndërmarr veprime qe të dëmtuarin ta privoj nga shfrytëzmi objektit kontestues.

Kjo rrethanë është tregues se i pandehuri ka prirje kriminale, se i njëjti nuk shpreh fare pendesë e as frikë nga forca e ligjit dhe obligimeve ligjore për t’u përmbajtur nga ndërmarrja e veprimeve të kundërligjshme, saqë edhe ne seanca shpërfaq qartazi se nuk është penduar për veprimet e kryerjes dhe se me një siguri të lartë shprehet se do ta përsëris veprën penale dhe ne mënyrë kundërligjore te realizoj qëllimin e tij.

Pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar, formalisht merret si rrethanë lehtësuese. Mirëpo, gjykata nuk i dha peshe të madhe pranimit të fajësisë kur dihet se këtu i pandehuri e pranon fajësinë duke e ditur se ka prova të mjaftueshme qe vërtetojnë veprimet e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet, e gjithashtu kur me rastin e pranimit të fajësisë i njëjti nuk shpreh fare pendim as keqardhje, përkundrazi ne prezencë të gjykatës paralajmëron se do ta përsërisë veprën penale.

Edhe përkundër qasjes shumë të mirë të palës së dëmtuar ne seancë, i pandehuri nuk kishte gatishmëri të kërkonte falje, as të shprehte keqardhje për veprën e kryer, përkundrazi ishte shumë armiqësor ndaj të dëmtuarit.

Si përfundim gjykata vlerësoj rrethanat renduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe te gjitha së bashku , raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se në aspektin përmbajtjesor rrethanat renduese i mbi peshojnë rrethanat lehtësuese e si rrjedhojë dënimi i shqiptuar të pandehurit Z. K. është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit Z. K. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

I dëmtuari nuk paraqiti kërkesë pasurore juridike, andaj gjykata nuk vendosi në lidhje me kërkesën pasurore juridike.

Andaj, duke u mbështetur në faktet, provat dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.709/22, me datë 27.10.2023

Procesmbajtësja:

Shpresa Kërnia

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.